



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:294660

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05873251

KA.nr.265/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Besimi Commerce” SH.P.K., me numër unik identifikues 810623456 me seli në Shtime rr. “Ibrahim Rugova”, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Kemajl Ademaj, avokat nga Ferizaj dhe Fisnik Salihu, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitore Byqmeti dhe Nazmije Aliu nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012 dhe kompensimin e dëmit në lartësi prej 99,917.19€, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 14.06.2024, në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurit, me datë 28.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Besimi Commerce” SH.P.K., e ushtruar ndaj të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- II. HEDHET POSHTË kërkesëpadia e paditësit “Besimi Commerce” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar anulimin e Vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012 të nxjerr nga i padituri Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- III. OBLIGOHET i padituri Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e fitimit të humbur, t’ia kompensoj paditësit shumën në lartësi prej 74,764.47€ (shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e dyzet e shtatë cent) me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, respektivisht 20.12.2019 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket inflacionit të llogaritur mbi bazën e shumës së dëmit të shkaktuar material në lartësi prej 25,152.72€ (njëzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi “Besimi Commerce” SH.P.K., përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 20.12.2019 ka iniciuar konflikt administrativ në bazë të nenit 68 të LKA-së kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak se i padituri nuk kishte vendosur sipas Aktgjykimit A.nr. 833/12 të datës 26.09.2019. Paraprakisht paditësit dhe “Besimi Commerce” SH.P.K. dhe Fabrika e Cimentor “Fushë – Krujë Cement Factory” SH.P.K., me datë 05.07.2012 kanë iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012 të nxjerr nga padituri Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, tani Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), për marrjen e masave të përkohshme mbrojtëse për aplikimin e tarifës prej 35% për çimenton e importuar si dhe kompensimin e dëmit si pasojë e vendimit kontestues në lartësi prej 242,808.00€, shumë kjo e zgjeruar përmes parashtresës së datës 05.10.2012 në lartësi prej 1,005,850.00€. Pas vendosjes nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr. 833/12 të datës 26.09.2019, vendimi i kontestuar ishte anuluar dhe çështja ishte kryer në rivendosje, mirëpo pasi që organi administrativ, në rastin konkret i padituri MTI, nuk kishte vendosur, paditësi i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për vendosje në përputhje me nenin 68 të ligjit për konfliktet Administrative. Paditësi përmes padisë ka theksuar se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Tutje thekson se me hyrjen në fuqi të masës së përkohshme mbrojtëse, e cila është aprovuar nga i padituri duke u shkelur procedurat dhe në kundërshtim me ligjin material ka vështirësuar importin e çimentos pasi që masa mbrojtëse prej 35% e bën jo konkurrues këtë artikull në tregun e Kosovës. Rrjedhimisht hyrja në fuqi e kësaj mase ka ndërprerë importin e këtij produkti. Andaj paditësi ka kërkuar nga gjykata kompensimin e dëmit për pamundësinë e importit me çka i është shkaktuar dëm – fitim i humbur.

Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, deklaramëve në seancat e mëhershme dhe parashtresave të dorëzuara duke shtuar se vendimi i të paditurit ka qenë i pa bazuar në gjendjen faktike dhe në ligj. Gjatë seancës së datës 14.06.2024 është lejuar precizimi i padisë sipas parashtresës së datës 14.05.2024 përmes

të cilës paditësi ka kërkuar kompensimin e dëmit material – fitimin e munguar në lartësi prej 74,764.47€, llogaritjen e inflacionit mbi bazën e shumës së dëmit të shkaktuar material në lartësi prej 25,152.72€, në total prej 99,917.19€, bashkë me kamatën ligjore prej 8% duke e llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit të kontestuar deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare, si dhe llogaritjen e inflacionit të vazhdueshëm në shkallën e cila do të publikohet nga Agjencia Kosovare e Statistikave si dhe kamatën ligjore nga nxjerrja e ekspertizës 04.04.2024 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3,226.00€. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar fakti se vendimi i të paditurit ka qene i pa bazuar ne gjendjen faktike, përkatësisht rrethanat në tregun e Kosovës, sa i përket çimentos dhe si i tillë ishte i pa bazuar ne ligj, rrethana këto të cilat paditësit ia japin të drejtën që të kërkojë anulimin e këtij vendimi, nga ana e gjykatës për të vendosur në mënyrë meritorë. Gjithashtu ka theksuar se në mënyrë te pakontestueshme është vërtetuar fakti se me vendimin e të paditurit deri sa i njëjti ka qenë në fuqi, paditësit i është shkaktuar dëm në formën e fitimit të humbur ashtu siç është përcaktuar edhe në ekspertizën financiare. Gjykatës i ka propozuar që të anuloj vendimin e kontestuar dhe ta obligoj të paditurin që në emër të dëmit të shkaktuar në formën e fitimit të humbur t'ia kompensoj shumën në lartësi prej 74,764.47€, llogaritjen e inflacionit mbi bazën e shumës së dëmit të shkaktuar material në lartësi prej 25,152.72€, kamatën ligjore prej 8% deri në momentin e hartimit të ekspertizës në lartësi prej 99,917.19€, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3,226.00€.

I padituri përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit duke theksuar se Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadija dhe padia e paraqitur nga paditësi të refuzohet si e pabazuar. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesja e autorizuar ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Ka shtuar se e kundërshton bazën e kërkesëpadisë nga fakti se konsideron se kemi të bëjmë me parashkrim të dëmit të shkaktuar, të fitimit të munguar që është përcaktuar edhe në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Kërkesë për vendosje numër protokolli 9701 e datës 02.12.2019, Aktgjykim A.nr.833/12 datë 26.09.2019, Vendim për marrjen e masave të përkohshme mbrojtëse nr.4508 datë 11.06.2012, Vendim për përfundimin e masave të përkohshme mbrojtëse me nr.6337 datë 25.07.2012 Kërkesë për rishqyrtim të vendimit e datës 27.06.2012, Ankesë e datës 22.06.2012, Dokumenti

me titullin informacion i datës 22.06.2012, Dokumenti me titullin kritikë e datës 25.06.2012, Ankesë e Pofix SHPK e datës 22.06.2012, Ankesë nga Jusaj-Metal e datës 22.06.2012, Shkresë nga Besimi Commerce SHPK drejtuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Kryeministrit, Dokumentacioni financiar i lëshuar sipas ekspertizës financiare, Kërkesë për kompensim dëmi drejtuar MTI-së me nr. të protokollit 8860 datë 04.10.2012, Kontratë furnizimi në mes të Fushë Kruja Cement Factory SH.P.K dhe Besimi Commerce, Aktvendim numër 05.2.1/630, 631, 632, 633 i Doganës së Kosovës;, Kronologji lidhur me vendosjen e masës mbrojtëse me importe të materialit ndërtimor-çimentos nga Republika e Shqipërisë e datës 13.06.2019, Rivlerësimi i tregut të çimentos pas masave të përkohshme mbrojtëse me nr.ref 07/2012 datë 07.08.2012, Lexohet plotësimi ekspertizës financiare i dorëzuar ne gjykate me date 19.04.2024, hartuar nga eksperti B.L., përgjigjen në letrën e dërguar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, numër reference dt.07 e datës 21.06.2012, kërkesë për fillimin e procedurës hetimore paraqitur nga “Sharrcem”, Ekspertiza financiare e hartuar prej Ekspertit B.L., e pranuar në Gjykatë më datë 21.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë dhe në padi si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata konstatoi se në këtë çështje të konfliktit administrativ fillimisht ishte vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr.833/12 të datës 26.09.2019, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadija e paditësit ishte anuluar Vendimi nr. 4508 i datës 11.06.2012 i të paditurit MTI dhe çështja ishte kthyer në rivendosje tek organi administrativ, mirëpo për shkak të mos nxjerrjes së vendimit nga ana e të paditurit, paditësi i është drejtuar gjykatës që të vendos në përputhje me nenin 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-047 për Masat Mbrojtëse në Importe (LMMI) i cili përcakton se: ” Çdo palë e interesuar që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, apo që i’u ka refuzuar kërkesa, apo rishikimi të kryer nga Ministria ka të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën kompetente me të cilën kërkon nga gjykata rishikimin e një veprimi ose vendimi të Ministrisë. Ankesa duhet të dorëzohet brenda dyzetepesë (45) ditësh kalendarike pas pranimit nga pala e interesuar të njoftimit për veprimin ose vendimin përkatëse.”, dhe nenit 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) i cili

përcakton se: “1. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin. 2. Në bazë të kërkesës së tillë, gjykata do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat akti administrativ nuk është nxjerrë. Organi kompetent ka për detyrë ta japë këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda shtatë (7) ditësh. Nëse nuk e bën këtë, apo nëse njoftimi i dhënë, sipas mendimit të gjykatës, nuk e arsyeton moszbatimin e aktgjykimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin, i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Këtë vendim gjykata do t’ia dërgojë organit kompetent për 14 ekzekutim dhe për këtë gjë njëkohësisht do ta njoftojë organin që ushtron mbikëqyrjen. Organi kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta ekzekutojë vendimin e tillë.”.

Gjykata i vlerësoi pjesërisht të bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat, kanë mbështetje në gjendjen faktike dhe janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Vendimi Nr.4508 i datës 11.06.2012, i padituri MINT, kishte marr masa të përkohshme mbrojtëse, ashtu që ka vendosur masën e përkohshme mbrojtëse në importet e çimentos për të gjitha vendet me tarifë prej 35%.

Nga Ankesë e datës 22.06.2012, gjykata konstaton se paditësi i është drejtuar të paditurit me ankesë ndaj vendimit për vendosjen e tarifës mbrojtëse prej 35% në produktet e çimentos.

Nga Kërkesë për rishqyrtim të vendimit e datës 27.06.2012, gjykata konstatoi se paditësi kishte parashtruar tek i padituri kërkesë për rishqyrtim të vendimit për vendosjen e tarifës mbrojtëse prej 35% në produktet e çimentos.

Nga Vendim për përfundimin e masave të përkohshme mbrojtëse me Nr.6337 datë 25.07.2012, gjykata konstaton se i padituri përmes këtij vendimi kishte përfunduar masën mbrojtëse të përkohshme për vendosjen e tarifës prej 35% për importin e çimentos.

Nga Ekspertiza financiare e hartuar prej Ekspertit B.L., e pranuar në Gjykatë më datë 21.02.2024 gjykata konstaton se fitimi i humbur i shkaktuar si pasojë e vendimit të të paditurit për vendosjen e tarifës prej 35% në importin e çimentos, për kohën sa ka qenë në fuqi, është 74,764.47€.

Nga Plotësimi i ekspertizës financiare i dorëzuar ne gjykate me datë 19.04.2024, i hartuar nga eksperti B.L., gjykata konstaton se humbur i shkaktuar si pasojë e vendimit të të paditurit për vendosjen e tarifës prej 35% në importin e çimentos, për kohën sa ka qenë në fuqi është 74,764.47€ dhe shuma e përlogaritur e inflacionit është 25,152.72€ dhe që obligimi në total pa kamatëvonesë rezulton në lartësi prej 99,917.19€.

Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje ka konstatuar se në i padituri përmes vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012, kishte marr masa të përkohshme mbrojtëse, ashtu që ka vendosur masën e përkohshme mbrojtëse në importet e çimentos për të gjitha vendet me tarifë prej 35%, ku si pasojë e këtij vendimi paditësit i ishte vështirësuar importimi i produkteve të çimentos deri me datën 25.07.2012, kur i padituri kishte nxjerr Vendimin Nr.6337 me të cilin kishte shfuqizuar masën mbrojtëse të përkohshme për vendosjen e tarifës prej 35% për importin e çimentos.

Bazuar në këtë, gjykata gjen se vendimi i kontestuar nga paditësi në këtë procedurë të konfliktit administrativ, është anuluar nga vet i padituri me datë 25.07.2012, dhe se kjo procedurë e konfliktit administrativ është e pa objekt për kërkesën për anulimin e vendimit për shkak se vendimi i cili kërkohet të anulohet rezulton të jetë anuluar nga vet i paditur me datën e lartcekur.

Për më tepër, ky vendim ishte anuluar edhe me Aktgjykimin A.nr.833/12 të datës 26.09.2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit, ishte anuluar vendimi Nr.4508 i datës 11.06.2012 dhe çështja ishte kthyer në rivendosje tek organi administrativ.

Ndonëse organi administrativ nuk kishte nxjerr vendim konform vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Themelore në Prishtinë, rezulton se vendimi ishte anuluar nga vet i padituri më 25.07.2012, ndërkaq Aktgjykimi A.nr.833/12, ishte nxjerr më 26.09.2019.

Andaj, meqenëse vendimi i kontestuar është anuluar para marrjes së këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi që të hedh poshtë kërkesëpadinë sa i përket anulimit të Vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012 të nxjerr nga i padituri Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë duke u bazuar në nenin 34 par 1.6 të LKA-së.

Gjykata aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket dëmit të shkaktuar – fitimit të humbur si pasojë e vendimit të kontestuar për kohën sa kishte qenë në fuqi vendimi i kontestuar dhe atë nga data 11.06.2012 deri më datën 25.07.2012, duke i njohur paditësit kompensimin në shumën në lartësi prej 74,764.47€, kjo në kuptim të nenit 46 par. 5 të LKA-së i cili përcakton se: *“5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.”*

Duke qenë se vendimi tashmë është anuluar nga vetë i padituri, ndërsa me Aktgjykimin A.nr. 833/12 të datës 26.09.2019 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike e ka vlerësuar si të kundërligjshëm dhe në riprocedurë i padituri nuk ka nxjerrë vendim tjetër, gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e kompensimit të dëmit ndaj paditësit.

Gjykata vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit për dëmin material në kuptim të nenit 154 të Ligjit mbi Detyrimet i nxjerr nga ish-RSFJ në vitin 1978, i cili përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”* dhe neni 155 i LMD-së i cili përcakton se: *“Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (demi jomaterial).”* si dhe në kuptim të nenit 189 i LMD-së i cili përcakton se: *“(1) I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë, ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar. (2) Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, me përjashtim të rastit kur ligji urdhëron diçka tjetër. (3) Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta, ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi.”*

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura, gjykata vlerësoi se janë plotësuar dy kushtet për kompensimin e dëmit, ashtu që dëmi ka bazë ligjore dhe ekziston lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës, e që në rastin konkret, paditësit i është shkaktuar dëm në formën e fitimit të humbur si pasojë e Vendimit Nr.4508 të datës 11.06.2012 të nxjerr nga i padituri me të cilën ishte vendosur tarifa prej 35% për importimin e çimentos, duke i shkaktuar paditësit humbje në

aktivitetin e tij ekonomik deri me datë 25.07.2012 ku vetë i padituri ka shfuqizuar vendimin me të cilin ishte vendosur tarifa prej 35% për importin e çimentos.

Gjykata për përcaktimin e lartësisë së kompensimit të dëmit në emër të fitimit të humbur, ia fali besimin provës së nxjerr përmes ekspertizës financiare të hartuar nga eksperti B.L., e pranuar në Gjykatë më datë 21.02.2024, ku përcaktohet se fitimi i humbur që i është shkaktuar paditësit si pasojë e vendimit për vendosjen e tarifës prej 35% në importin e çimentos, për kohën sa ka qenë në fuqi, është 74,764.47€.

Nga Plotësimi i ekspertizës financiare i dorëzuar ne gjykatë me datë 19.04.2024, i hartuar nga eksperti B.L., gjykata konstaton se është përlloritur shuma e inflacionit për vlerën e dëmit të shkaktuar nga ku ka rezultuar se për dëmin në vlerë prej 74,764.47€, inflacioni ka rezultuar në shumë prej 25,152.72€, por që gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit sa i përket llogaritjes së inflacionit në vlerën e dëmit të shkaktuar në formën e fitimit të humbur për arsye se nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi dhe se për shkak të vonesës në pagesë aplikohet kamata ligjore e përcaktuar në nenin 377 të LMD-së, për çfarë në kuptim të kësaj dispozite gjykata vendosi që i padituri shumë e caktuar për kompensimin e dëmit në formën e fitimit të humbur të paguaj me kamatë si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit lidhur me parashkrimin e kërkesës por gjykata këtë pretendim e vlerësoi si të pabazuar për faktin se paditësi fillimisht sipas padisë së ushtruar me datë 05.07.2012 kishte kërkuar edhe kompensimin e dëmit por gjykata me Aktgjykimin A.nr. 833/12 të datës 26.09.2019 çështjen e kishte kthyer në rivendosje në organ administrativ ndërsa ashtu siç është arsyetuar më lartë, për shkak se i padituri nuk kishte vepruar sipas vendimit të gjykatës, paditësi kishte paraqitur kërkesë në kuptim të nenit 68 LKA-së së bashku me kërkesën për kompensimin e dëmit, andaj gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë është e lejuar sipas nenit 68 të LKA-së ashtu që pretendimet për parashkrim janë të pabazuara.

Lidhur me kamatën ligjore, gjykata vendosi në kuptim të nenit 277 të LMD-së ashtu që obligoi të paditurin që paditësit shumë e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi të ia kompensojë së bashku me kamatë si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, respektivisht 20.12.2019 deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.



Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.265/22, datë 28.06.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.